



Myqet në shtëpi

Shkaqet, efektet, ndihma



Myk në shtëpi

Myqet ndodhen kudo në botë. Në banesa ato janë të padëshiruara. Zhvillimi masiv i tyre në to mund të çojë në shfaqjen e ngacmimeve apo acarimeve në zonën e frymëmarjes dhe në reaksione alergjike. Pra myku nuk duhet të jetë pjesë e banesës. Shkaku është gjithmonë rritja e lagështirës. Në këtë broshurë shpjegohet sesi ndodh rënia dhe zhvillimi i mykut. Sa i madh është rreziku në rastin e lindjes së mykut për banorët, dhe se çfarë mund të bëhet kundër tij në mënyrë që të mos ndodhë aspak lindja dhe zhvillimi i tij.



Myqet nuk qëndrojnë në të thatë


Myqet janë pjesë e natyrshme e mjedisit tonë. Sporet e tyre gjenden thuajse kudo, pra edhe në mjediset e brendshme. Normalisht ato nuk përbëjnë rrezik. Por gjithsesi nëse koncentrimi i mykut tejkalon një masë të caktuar, atëherë mund të çojë në probleme shëndetësore për banorët. Myqet kanë nevojë për shumë lagështi për rritjen dhe zhvillimin e tyre. Shkaqet e rritjes së lagështisë brenda ndërtesave mund të jenë:

- a) Rritja e drejtëpërdrejtë e lagështisë p.sh. nëpërmjet:
 - Çati me defekte (veçanërisht ato të sheshta), hulluqet dhe tubat e shkarkimit
 - Të çara në mur
 - Tharje e pamjaftueshme pas masave ndërtimore
 - Depërtim i ujit si pasiojë e dëmtimit të tubacioneve, përmytjeve etj.

- b) Largim i pamjaftueshëm e lagështisë së rritur të mjediseve nëpërmjet:
 - Pamjaftueshmërisë së ngrohjes dhe ajrimit, veçanërisht në ndërtesat e hermetizuara nga ajri (pa mundësi depërtimi ajri)
 - Kondensimit të lagështisë së ajrit në zonën e mureve të ftohta, të cilat paraqiten problematike për shkak të pamjaftueshmërisë të termoizolimit, veçanërisht në ndërtesat e vjetra. Gabimet ndërtimore, si p.sh. urat termike në ndërtesa çojnë gjithashtu në kondensimin e avujve të ujit përgjatë këtyre sipërfaqeve.

Renditja e problemeve tregon se krahas të matave ndërtimore dhe fiziko – ndërtimore, edhe banorët kontribuojnë në rritjen e lagështisë në ndërtesa. Pamjaftueshmëria e ajrosjes e lidhur me veprimtari, gjatë të cilave krijohet shumë lagështi, si dushi, gatimi, tharja e rrobave, ekzistenca e akuarjumeve të mëdhej etj., mund ta rrisin lagështinë në ndërtesë etj. sasive të përbalueshme. Kjo bëhet para së gjithash problematike, nëse ndërtesat për shkak të kursimit të energjisë

termoizolohen me kosto të larta.



Secili mund ta testojë lagështinë në banesën e tij. Edhe paisje të thjeshta të matjes së lagështisë (Hygrometer) orientojnë mbi lagështinë relative të mjedisit. Në mjedisin e brendshëm ajo duhet të ishte vezhdimisht 65 – 70 % (në dimër më pak) dhe dhe të mos tejkalojë vlerën 80% në sipërfaqet e mureve, për të zvogëluar rrezikun e lindjes dhe zhvillimit të mykut.


Nëpërmjet rritjes së hermetizimit të dritareve



etj. gjatë reparimit të shtrenjtë të ndërtesave shkëmbimi i natyrshëm i ajrit zvogëlohet. Lagështia e lindur në ndërtesë duhet të zhvendoset nëpërmjet ajrosjes së përforcuar. Në radhë të parë qëndrojnë në lidhje me këtë ndërtimi i sistemeve mekanike të ajrosjes, pra

impjante teknike, të cilat sigurojnë në vijimësi një këmbim të mjaftueshëm të ajrit pa bërë të mundur humbjen e energjisë për ngrohje që nevojitet në periudhën në të cilën përdoret ngrohja.

Myku, çfarë është ai?



Myku është një koncept i përgjithshëm për këpudhat, të cilat mund të krijojnë fije tipike këpudhash dhe spore. Myqet në fazën e rritjes formojnë vargje qelizash. Në shumicën e rasteve këto janë pa ngjyrë, kështu që myku në këtë fazë nuk mund të dallohet me sy të lirë. Për tu shtuar dhe përhapur myqet formojnë spore. Këtë sjesh herë janë me ngjyrë, kështu që rënia e mykut në këtë fazë është e dallueshme edhe me sy të lirë, si p.sh. si njolla të zeza ode të verdha.

Rritja dhe zhvillimi i myqeve në mjediset e brendshme përcaktohet kryesisht nga tre faktorë: lagështia, prania e ushqimit për myqet dhe temperatura.


Myqet mund të shfrytëzojnë për ushqim një sërë materialesh si p.sh.:

- Lloje të ndryshme drurësh, pllaka zdrukthi
- Letër, karton ambalazhi, kartone të tjera, si dhe pllaka gipsi
- Letra murale, dhe ngjitës të letrave murale
- Plastika, gomë, silikon

- Qilima, ngjitësa për shtresat e dysHEMEVE
- Bojra, Ilaqe
- Lëkurë

Myqet mund të shfaqen edhe mbi çimento dhe beton. Myqet mund të rriten madje edhe mbi materiale, të cilat nuk ofrojnë lëndë ushqimore, nëse mbi to kanë rënë grimca organike dhe pluhur nga ajri, (p.sh. mbi qelq).

Myqet mund të rriten mbi materiale, nëse është e pranishme një lagështi minimale e caktuar. Në këtë rast nuk është vendimtare lagështia e përgjithshme e materialit, por vetëm uji “i lirë” i që i vihet në dispozicion myqeve. Myqet mund të rriten edhe mbi apo në materiale, të cilat nuk duken të lagura. Mjafton një lagështi relative e ajrit rreth 80% në sipërfaqen e materialit. Kushte veçanërisht të mira për rritje gjenden gjithmënë atëhere kur ndodh vesimi mbi ose në brendësi të materialit.



Myqet – vetëm të bezdisshëm apo dhe të dëmshëm

Një sërë studimesh mbi ndikimin ndaj shëndetit të shkaktuar nga myqet venë re një lidhje ndërmjet ngarkesës me myqe dhe problemeve me rrugët e frymëmarjes. Sporet dhe produktet e shkëmbimit të lëndëve të myqeve munden të thithen me anë frymëmarjes në ajër dhe të shkaktojnë shqetësime dhe reaksione te njerëzit. Megjithatë në asnjë nga këto studime deri tani nuk mund të përcaktohej se në çfarë koncentrimi në ajër duhet llogaritur që myqet të fillojnë e të kenë efekte negative shëndetësore te njerëzit.

Pranohet që si rregull të gjitha myqet janë në gjendje të shkaktojnë reaksione alergjike te personat të predispozuar për këtë. Në rastin e alergjive sistemi imunitar nuk mbrohet kundër lëndëve të huaja të rrezikshme (p.sh. shkaktuesve të sëmundjeve), por gabimisht kundër lëndëve të huaja në vetvete të parrezikshme, si p.sh. poleneve, pjesëve të ushqimeve.

Në kontaktin e parë me lëndën e huaj (antigeni) nuk shfaqet ende nadonjë reaksion alergjik, por trupi përgatitet për të luftuar dëmtuesit e supozuar nëpërmjet prodhimit të antitropave (lëndëve mbrojtëse). Një person të tillë e trajtojmë si të “ndjeshëm”.

Vetëm pas kontaktit të përsëritur me lëndën e huaj mund të shfaqen simptomat alergjike, tek të cilat në të gjithë trupin zhvillohet një zinxhir i tërë reaksionesh, në fund të të cilave shfaqen dhe qëndrojnë simptomat e reaksioneve tipike të alergjisë, si sekrecione nga hundët, teshtima, sy të skuqur, dëmtime dhe njolla e puçra në lëkurë etj. Simptomat e

përshkruara më shpesh në mjediset e brendshme të shkaktuara nga myqet janë të pa specifikuar. Kështu p.sh. inflamacionet e lehta të indeve të lëkurës, të fytit dhe hundëve si dhe kollë apo dhembje koke ose lodhje. Infeksionet nga myqet (mukozat) shfaqen shumë rralë dhe vetëm tek personat shumë të ndjeshëm e me sistem imunitar të dobësuar. Efektet alergjike dhe lehtë imflamatore mund të shkaktohen si nga myqet e gjalla, ashtu edhe nga ato të vdekura, ndërkohë që për shkaktimin e infeksioneve janë të afta vetëm myqet e gjalla.






Alergjive

Nuk duhet nënvleftësuar: myqet si shkaktarë të

Myqet – problemi i fshehur

Shpesh herë myqet zhvillohen në fshehtësi, pa u diktuar. Një aromë e lagësht e pakëndshme ose njollat e para të errëta në tavanet apo mobiljet tregojnë praninë e problemit. Në rast se dyshohet mbi praninë dhe zhvillimin e myqeve të fshehura, duhet që mjediset e prekura të kontrollohen shumë mirë. Nëse është e nevojshme hapësirat pas vendeve të mbuluara, tavaneve ose mureve duhet të çlirohen nga këto mbulesa me qëllim që të arrihet te burimi i zhvillimit të mykut. Gjithnjë e më shumë po futen në veprim qentë e specializuar për gjetjen e vatrave të mykut, për të zbuluar në këtë mënyrë vendet e padukshme të kontaminuara me myk, meqenëse thuhet se gjitha myqet çlirojnë në ajrin e mjedisit lëndë organike, të cilat një qen i stërvitur posaçërisht mund t'i nuhasë. Në rastin e përdorimit të qenve për nuhatjen e mykut duhet kuptuar se qeni gjen një zhvillim myku të fshehur apo të mbuluar, por nuk mund të japë asnjë lloj informacioni mbi përmasat reale të përhapjes dhe zhvillimit të tij dhe mbi një rrezik të mundshëm shëndetësor për banorët.

Një metodë tjetër është ajo nëpërmjet matjes së substancave të caktuara të lëshuara në mjedis nga metabolizmi i mykut, nëpërmjet të cilës të arrihet të zbulohet dhe vlerësohet dëmi i një myku të fshehur. Këto matje ashtuquajtura matje “MVOC” (*microbial volatile organic compounds*) janë gjithsesi nga pikpamja e vërtetësisë së rezultateve, të diskutueshme. Kështu nuk është gjithnjë e qartë nëse lidhjet organike të lëshuara e të matura në mjedis janë me të vërtetë me të njëjtën prejardhje. Fakti i rritjes së koncentrimit të “MVOC” (*microbial volatile organic compounds*) në mjedisin e brendshëm nuk thotë asgjë për rreziqet shëndetësore tek banorët. Aq më pak, që për



shkak të këtyre matjeve, duhet të kryhen meremetime.

Më i qartë është fakti i zhvillimit sipërfaqësor të mykut, i dallueshëm tashmë edhe me sy të lirë, p.sh. mbrapa dollapeve, në të thelluarat murale (kamare) etj.. Në rastin e një zhvillimi të madh të mykut (në një sipërfaqe më të madhe se afërsisht 20 – 50 cm²) nuk ka nevojë të analizohet me kosto të larta se sa e madhe është ngarkesa e rënies së mykut në banesë dhe se për çfarë lloje myqesh bëhet fjalë për secilin rast. Duhet të vepohet menjëherë. Nëse zbulohen vatrave të mykut duhet të mësohen shkaqet e rënies dhe përhapjes së tij. Vetëm më pas duhet që pjesa e prekur nga myku të riparohet, ndërkohë që për çdo rast duhet të luftohen shkaqet e rënies dhe përhapjes së tij. Pra së pari duhet të sqarohet nëse ka burim të mykut dhe kush janë shkaqet e rënies dhe zhvillimit të tij (të



meta ndërtimore, sjellje e gabuar e përdoruesve të banesës, etj.). Një kontroll i tillë kërkon njohuri të mira profesionale dhe duhet të kryhet nga njerëz të specializuar. Një qesje thjeshtë skematike do të ishte shumë problematike. Për çdo rast duhen vlerësuar dhe tërhequr të gjitha informacionet që gjenden aty. Përpara kryerjes së kontrolleve të kushtueshme mikrobiologjike duhet të kryhet fillimisht një kqyrje e situatës në vend. Gjatë kësaj kqyrje duhet që mundësisht të përcaktohen shkaqet e rënies dhe zhvillimit të mykut dhe hidhen në

një protokoll. Përveç kësaj nëpërmjet kontrollit duhet të sqarohen nëse në jediset e brendshme ka një apo më shumë vatra të zhvillimit të mykut. Nëpërmjet një analize të ajrit të mjedisit të brendshëm si dhe të pluhurave të shtëpisë të matrialeve të zëna nga myku mund të vlerësohet saktë masa e dëmit dhe rreziku për shëndetin. Analizat duhet të kryhen vetëm në laboratorë të specializuar, përndryshe nuk mund të përjashtohen veprime të gabuara gjatë matjeve dhe interpretime të gabuara të rezultateve.



Kujdesuni në dhënien e porosive apo detyrës për matjet e myqeve që laboratorët të ushtrojnë masa mbi sigurinë e kualitetit dhe p.sh. të marin pjesë rregullisht dhe me sukses në kualifikimet periodike mbi procedurat e matjeve. Nëse keni dyshim në korrektësinë e laboratorit, atëherë kërkoni ndihmë në zyrën vendore shëndetësore ose këshillohuni në shoqatat vendore të konsumatorëve. Nëse dyshonë se në banesën tuaj ka vatër të mykut, e cila mund të dëmtojë shëndetin tuaj, atëherë këshillohuni pa tjetër me zyrën vendore shëndetësore ose qendrën e mbrojtjes së konsumatorëve. Nëse vuani nën probleme shëndetësore, për të cilat dyshoni se mund të ketë lidhje me zhvillimin e mykut në banesën tuaj, atëherë drejtojuuni mjekut tuaj ose një qendre mjekësore mjedisore

Çfarë duhet bërë nëse është zbuluar myku?

Kostatimi i një vatre myku në mjediset e brendshme nuk është duhet trajtuar si një rrezik akut shëndetësor. Përmasat e rrezikut ndaj shëndetit varet nga intensiteti dhe lloji i dëmtimit si dhe nga ndjeshmëria ndaj faktorëve të jashtëm të përdoruesve të banesës dhe shpesh nuk mund të përcaktohet saktë. Zhvillimi i mykut në mjediset e banimit, edhe pa këtë varësi të saktë përmasave të përhapjes së tij, shihet si problem higjienik dhe prandaj nuk duhet të pranohet e tolerohet. Në këtë rast gjen përdorim parimi i masave parandaluese, sipas të cilit ngarkesa me myk duhet minimizuar përpara se të arrihet në lindjen e sëmundjeve.

Nëse vlerësohet se ka ngarkesa të lindjes dhe përhapjes së myqeve në mjediset e brendshme, atëhere duhet të vijojnë masat e riparimit. Edhe vatra të vogla të mykut në mjediset e brendshme, për shkak të masave paraprake shëndetësore, duhen të shkatërrohen. Gjithsesi një riparim i dëmeve të myqeve, pa riparuar shkaktarët, nuk do të kishte kuptim, meqenëse herët apo vonë do të kemi sërish të bëjmë me lindjen dhe zhvillimin e mukut. Prandaj është e domosdoshme të sqarohen shkaqet e lindjes dhe zhvillimit të mykut, veçanërisht çështja e rritjes së nivelit të lagështisë.



Zhvillimi i mykut në banesat me qera

Lindja dhe zhvillimi i mykut në një banesë me qera shihet si një e metë e mjetit të dhënë me qera. Mbi shkaqet dhe çështjen se kush duhet të përgjigjet për riparimin e dëmeve shpesh herë në praktikë lindin grindje, të cilat shpesh duhet të vendoset në gjyq pas dëgjimit të ekspertëve.

Meqenëse rënia e zhvillimi i mykut në mjediet e brendshme paraqet një problem dhe nuk mund të përjashtohet dhe një problem shëndetësor, për shkak të masave preventive shëndetësore dëmet duhet të riparohen sa më

shpejt të jetë e mundur, mundësisht dhe me anë të mirëkuptimit dypalësh.

Gjatë lëshimit të vërtetimeve për shqetësimet shëndetësore për shkak të ngarkesës me myk është e rëndësishme që diagnoza le të dallohet qartë lidhja ndërmjet shqetësimeve dhe ngarkesës së mykut.



E rëndësishme



Udhëzimet tona nuk mund të zëvendësojnë një këshillim ligjor për çdo rast konkret. Në rast dyshimi mbi situatën ligjore dhe të drejtat dhe detyrimet do të ishte më mirë që qeramarësi dhe qeradhënësi të këshillohen në kohën e duhur mbi çështjet ligjore. Zurat këshillmore, siç janë shoqatat e qeramarësve apo ato të qeradhënësve mundet të ofrojnë ndihmë në këtë rast.

Gjatë riparimit të dëmeve nga myqet
detyrim është:

Veshja mbrojtëse



Luftë mykut

Nëse nuk mund të fillohet menjëherë me masat për riparimin, duhet testuar nëse vendet e prekura nga myku, përkohësisht, mundësisht pa shkaktuar përshtjella myku, të mund të pastrohen dhe dezinfektohen, p.sh. me alkool etilik me përqëndrim 70% (etanol) në sipërfaqe të thata dhe me një përqëndrim 80% për sipërfaqet e lagështa.

Lagështia e ajrit në mjedis mund të reduktohet nëpërmjet ajrosjes dhe ngrohjes së qëllimshme dhe në këtë mënyrë të pengohet lindja sërisht e mykut. Gjithsesi kjo masë do të ketë kuptim vetëm atëherë nëse më parë janë larguar sporet e mykut të ndodhura aty për të shmangur koncentrimin e lartë në ajrin e mjedisit dhe lindjen e vatrave dytësore.

Nëpërmjet një ajrosje dhe ngrohje të shtuar, si dhe nëpërmjet tërheqes së mobiljeve nga muret (afërsisht 10 cm distancë) mundet që rreziku nga lindja e pikës së vesës (kondensimi) në vendet vështirë të depërtueshme nga ajrosja të zvogëlohet dhe në këtë mënyrë të parandalohet një lindje dhe zhvillim i mëtejshëm i mykut. Edhe kjo masë paraprake është e mundur vetëm atëherë kur sporet e pranishme të mykut janë larguar më parë. Kusht bazë për suksesin e një riparimi është shmangia e shkaqeve, të cilat kanë çuar në shfaqjen dhe zhvillimin e mykut. Duhet riparuar dëmet që vijnë nga problemet ndërtimore dhe duhet sqaruar shfrytëzuesit e mjediseve të banimit (banorët) se si mund të shmangen në të ardhmen përhapja e mykut.

Kostot e riparimit duhet të jeni në verësi të përmasave të dëmit dhe llojit apo mënyrës së përdorimit të mjedisit. Në këtë rast një rol luajnë çështje e mëposhtme:

- Madhësia e sipërfaqes së zënë nga myku

- Ngarkesa në myk (sipërfaqe të veçuara ose shtresëzim i madh i mykut)
- Thellësia e mykut (sipërfaqësor apo dhe në shtresa të thella)
- Llojet e myqeve të zhvilluara në këto qipërfaqe (të rëndësishëm për rreziqet nga alergjitë dhe infeksionet, disa lloje myqesh formojnë toksina helmuese)
- Llojet e materialeve mbi të cilat është zhvilluar myku (si materiale të zmontueshme lehtë ose mbi mur)
- Lloji i shfrytëzimit të mjedisit (magazinë, mjedis banimi, kopësht fëmijësh, spital)

Me ndihmën e këtyre kriterëve duhet bërë me profesionalizëm një vlerësim i përgjithshëm. Përfundimisht gjatë riparimit duhet të formulohen masat mbrojtëse që rrjeshin prej këtej.

Punimet riparuese të një sipërfaqe më të vogël, si p.sh. vetëm në zhvillim sipërfaqësor të mykut, sipërfaqe të zëna nga myku jo më të mëdha se afërsisht $\frac{1}{2} m^2$, me të meta ndërtimore, në të cilat nuk priten rreziqe për personat e shëndetshëm, mundet të kryhen në përgjithësi pa pjesëmarrjen e specialistëve, por gjithsesi duhet tërhequr këshillë e specializuar. Në sipërfaqet e lëmuara, si metal, qeramikë, qelq, mund të kryhet një pastrim me ujë ose detegjentë normal shtëpiakë. Material poroze të zëna nga myku, si letrat murale, pllaka gipsi, mur poroz, mbulesa tavanesh, mundet të pastrohen me vështirësi ose aspak, meqenëse zhvillimi i mykut mund të ketë depërtuar deri në thellësi të materialit. Pllakat e prekura nga rënia e mykut ose mure të lehta ndarëse do të ishte më mirë të ç'montoheshin. Në materialiet e pa ç'montueshme duhet të sigurohemi që myku të largohet plotësisht. Kjo do të thotë edhe në shtresat e thella.



Na rastin e drurit në parim duhet dalluar ndërmjet të ashtuquajturës “ngjyrime blu të drurit” (i cili nuk është vetëm në ngjyrë blu të hapur, por dhe në gri, kur druri i është ekspozuar lagështirës dhe fenomeneve atmosferike), në rastin kur myku është sipërfaqësor dhe zhvillimit aktiv të mykut për shkak të dëmtimit akut nga lagështia me zhvillimin të fortë të sporeve të mykut. Në rastin e “Blusë së drurit” normale, zakonisht nuk ka nevojë riparimi. Në të kundërt në rastin e rënies aktive të mykut në dru riparimi është shumë i vështirë të kryhet dhe në shumicën e rasteve druri duhet hequr dhe hedhur. Në raste të veçanta mundet që rënia sipërfaqësore e mykut të hiqet me anë të zmerilimit. Në këtë rast duhet të kihet parasysh masa të veçanta mbrojtëse. Pjesë

mobijesh me sipërfaqe të mbyllura të zëna nga myku si; karrike, dollapë, duhen pastruar sipërfaqsisht në gjendje të njomë, më pas tharë dhe sipas rastit të dezinfektohen me alkool etilik 70 – 80 %. Kujdes: fshini sipërfaqet me një shami të njomë me alkool dhe mos e spruconi! Ka rrezik zjarri dhe eksplozioni! Përveç kësaj përdorni maska mbrojtëse për frymëmarrje!

Orenditë me mbulesa të zëna nga myku si, kolltuqe e divane, mund të pastrohen rrallë siç duhet nga myku, dhe prandaj normalisht duhen asgjësuar. Tekstilet, të cilat i ka zënë myku, në mjediset e banesave , si; qilima apo perde, në shumicën e rasteve, gjithashtu mund të pastrohen siç duhet vetëm me kosto të lartë, kështu që për asgjësimin e tyre duhen të meren në konsideratë kostot e blerjes së tyre.

Letrat murale dhe zëna me myk, si dhe fugat (hapësirat) e silikonit duhet të hiqen. Vendet me myk sipërfaqësor duhen pastruar në të njomë ose duke e larguar atë me anë të një fshese me korent të paisur me filtër të imët ndaj pluhurave dhe në fund të trajtohen me akool etilik 70 – 80% nën kujdesin e një zjarri apo eksplozioni të mundshëm (përdorni vetëm sasi të vogla, ajrosini mirë, mos pini duhan, të mos jetë zjarr të hapur), si dhe të respektohen kërkesat e mbrojtjes në punë (doreza mbrojtëse, maskë frymëmarrje, syze mbrojtëse).

Pas riparimit të dëmit të mykut duhet kryer një pastrim intensiv në mjedisin rreth vendit të riparuar. Mbeturinat me myk pas riparimit mund të hidhen në qese plastike dhe më tej në kazanin e plehrave.

E rëndësishme

Shpesh rekomandohet përdorimi i një tretësire uthulle. Në shumicën e rasteve kjo ndërhyrje është pa vend, meqenëse shumë materiale ndërtimi, veçanërisht gëlqerja neutralizojnë efektin e uthullës dhe përveç kësaj në material përfundojnë lëndë ushqyese organike, të cilat madje mund ta stimulojnë rritjen e mykut.

Gjithashtu në këshillojmë në rastin përdorimit të solucioneve (solucione me fungicide) kimike kundër mykut në mjediset e brendshme, meqensëse nuk përjashtohet që këto lëndë mbetan për një kohë të gjatë në mjediset e brendshme dhe rrezikojnë shëndetin e banorëve.

Riparimi i materialeve të zëna nga myku duhet të ketë si qëllim të largojnë plotësisht ato. Një çngjyrim i thjeshtë i sipërfaqes së yënë me myk nuk mjafton, sepse edhe nga myku i vdekur mund të shfaqen efekte alergjike dhe ngacmuese.

Më tej duhet pasur parasysh, se p.sh. nuk mund të përjashtohen rreziqe shëndetësore si p.sh. për allergjikët ose të dëmtuar kronikë të rrugëve të frymëmarrjes, për persona me sistem imunitar të dobësuar, aq sa këtij grupi personash nuk u lejohe të kryejnë e të drejtojnë punë të riparimit të myqeve.

Punime komplekse të largimit dhe riparimit të dëmeve të myqeve duhen kryer nga firmat e profilizuara. Në këtë rast duhet ngarkuar firma, të cilat kanë përvojë me punë të tilla riparimi, me rreziqet që shfaqen në këto raste, masat mbrojtëse që duhen marrë dhe rregullat dhe rekomandimet që duhen respektuar.

Masat mbrojtëse gjatë riparimit të mykut:

Mos i prektni myqet me duar të pambrojtura!

Vishni doreza mbrojtëse! Mos merni frymë përpara myqeve, vendosni maskë mbrojtëse!

Shmangni rënien e myqeve në sy! Vendosni syze mbrojtëse!

Mbas përfundimit të riparimit bëni dush dhe lani veshjet!



Shmangni patjetër

Lagështinë për shkak të kondensimit

Parandalimi është më i mirë se shërimi

Kushti më i rëndësishëm për rritjen e mykut është prania e lagështirës, gjë që mund të ketë si shkak mangësi ndërtimore apo dhe sjellje të gabuar të banorëve ndaj ajrosjes, ngrohjes apo ftohjes në mjediset e tyre të banimit.

Masat e duhura nga pikpamja ndërtimore si dhe sjellja e duhur gjatë shfrytëzimit të banesës duhet të ndikojnë së bashku për të patur një banesë pa mundësinë e lindjes dhe përhapjes së myqeve.

Kusht bazë për një banesë pa myk është nga njëra anë ngritja e ndërtesës sipas teknologjisë së fundit.

Shmangies së rritjes dhe zhvillimit të myqeve për shkak të dëmeve nga lagështia i shërbejnë:

- Mbrojtja minimale termike sipas (DIN 4108-2, 2001-03)
- Mbrojtja nga rrebeshet sipas (DIN 4108-3)
- Hidroizolimi kundër rritjes së lagështisë në dyshemetë (DIN 18195),
- Konskruksione të standardizuara të çatave (sipas standardeve profesionale)
- Instalime hermetike hidraulike

Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar mureve të jashtëme, tavaneve dhe çatisë, të cilat janë termoizoluar në mënyrë të pamjaftueshme ose të gabuar ose vendeve të tjera që janë të pahermetizuara, te të cilat shtohet kagështia për shkak të kondensimit.

Në mjediset e banesave të sapo ndërtuara është e nevojshme ajrosja intensive për një periudhë të caktuar kohe për shkak lagështisë të lidhur me ndryshimet të reja ndërtimore. Në rastin e shfrytëzimit të banesave me lagështi dhe dendësi të madhe të ajrit në brendësi të ndërtesës

nganjëherë nuk është e mundur që lagështia e ajrit të reduktohet në masën e duhur me anë të ajrosjes të vështirë manuale. Në këto raste mund të ndihmojë një këmbim mekanik i ajrit.

Për prurjen dhe largimin (ajrosjen) mekanike vlejné dy sisteme:

- Nevoja e ajrimit me anë të ventilatorëve në mjediset e banimit me lagështi të madhe. P.sh. në kuzhina apo mjedise sanitare (banjo, tualete, etj.). Ventilatorët rregullohen në varësi të qëllimit me anë të sensorëve të lagështisë.
- Sisteme prurjes dhe largimit (këmbimit) të ajrit me përfitim të nxehtësisë. Në këto ampjante, të cilat përdoren aq shpesh, që dritaret të rrinë të hapura gjatë periudhës së ngrohjes, duhet që këmbimi i ajrit të përshtatet ngarkesës së lagështisë dhe ajri të thithet atje ku janë të koncentruara burimet e lagështisë.

Në impjantet qendrore të ajrimit duhet patur parasysh kontrolli dhe servisi periodik i tyre. Përndryshe ato mund të kthehen vetë në burime të baktereve. Së fundmi në impjante e mëdha për ajrosjen e gjithë ndërtesës përdoren dhe këmbyesit e nxehtësisë duke shfrytëzuar nxehtësinë e tokës. Në pranverë dhe verë ato mund të çojnë në një problem mikrobiologjik, nëse në muret e këmbimit të nxhehtësisë shfaqet lagështi relative e lartë dhe madje kondensat.

Edhe përdoruesit e banesës mund të kontribuojnë ma anë të sjeljes së tyre që myku të mos gjejë kushte të favorshme për shfaqjen dhe zhvillimin e tyre. Me anë të ajrosjes dhe ngrohjes së duhur mundet të kufizohet lagështia në ndërtesë.

Këshilla për ajrosjen e duhur

Kuzhina



Në kuzhinë nëpërmjet tërheqes dhe nxjertes jashtë të ajrit të ngarkuar mundet të largohet shumë lagështi nga mjedisi i brendshëm. Një largim i tillë e ajrit të dendur e me lagështi të gatimit dhe veçanërisht të gatimit me gaze të lëngshme është mjaft e rëndësishme. Pajset e thithjes dhe të largimit të avujve të gatimit me ndryshim të drejtimit të lëvizjes së ajrit nuk janë të përshtatshme për uljen e lagështisë së ajrit në kuzhina.

Banjo

Pas dushit në banjo duhet larguar uji nga muret dhe dyshemeja. Pas dushit dritaret e banjos (nëse ka) të hapen krejtësisht për një kohë të shkurtër. Në banjot pa dritare duhet të kihet parasysh që sistemi i ajrosjes të funksionojë siç duhet. Në këtë rast rekomandohet instalimi i një sistemi mekanik ajrimi mundësisht i komandueshëm me anë të sensorëve. Peshqirët dhe muret e lagur, pavarësisht ajrosjes për një kohë të shkurtër, mund të përmbajnë ende shumë ujë, prandaj është mirë që peshqirët të thahen në radiatorët ngrohës dhe dritaret duhen lënë të hapura deri sa ata të jenë tharë në një farë mase (në banjo ngrohja në dimër nuk duhet fikur. Kjo shpejton ndjeshëm tharjen e peshqirëve. Në këto raste do të mjaftonin pak minuta)



E rëndësishme

Për uljen e lagështisë në dhoma duhet të kryhet disa herë në ditë një arjosje e shkurtër(5 – 10 minuta me dritare të hapura krejtësisht)

Mjedise pak ose aspak të ngrohura



Mjedise më pak të ngrohura, si p.sh. dhomat e gjumit, nuk duhet të ngrohen me anë të ajrit të ngrohtë (në mbrëmje) që vjen nga mjediset e tjera. Në mjedisin më të ftohtë mund të ndodhë kondensimi në mure ose në xhamat e dritareve. Gjatë përdorimit të dhomës së gjumit pak të ngrohur, mëngjeseve, pas ngritjes nga shtrati, nëpërmjet një ajrosje të mirë duhet kujdesur për largimin e lagështisë së ajrit (çdo njeri nxerr avuj uji gjatë gjumit). Në mjediset, të cilat nuk përdoren dhe ngrohen për një kohë të gjatë, në rastin e ripërdorimit duhet më parë të kryhet një ajrosje e shpeshtë.

Ajrosja e duhur parandalon mykun



E rëndësishme është që lagështia që lind nga aktivitetet në mjedis (lagështia që del nga njerëzit, dushi, gatimi, larja etj.) të dalë jashtë nëpërmjet ajrosjes së rregullt.

Mundësia që lagështia të largohet nga mjedisi me anë të ajrosjes bazohet në atë që ajri, në varësi të temperaturës, mund të thithë sasi të ndryshme të avujve të ujit. Ajri i ngrohtë për të njëjtën lagështi relative të ajrit përmban më shumë ujë se sa ajri i ftohtë. Ajri i ftohtë i jashtëm në dimër përmban më pak ujë, ndonëse lagështia relative e tij është më e lartë.

Ajri i ftohtë i jashtëm, i cili hyn në mjediset e brendshme gjatë ajrosjes, thith lagështi gjatë ngrohjes, e cila transportohet sërish jashtë me ajrin e ngrohtë. Në rastin e një ajri të jashtëm shumë të ftohtë mundet që edhe në kohë shiu nëpërmjet ajrosjes në mjedisin e brendshëm të përftohet një tharje e mirë e ajrit. Sa më i ftohtë të jetë ajri aq më shumë ujë mund të thithë ai gjatë ngrohjes. Që këtë në dimër me anë të ajrosjes me ajin e jashtëm të ftohtë mund të nxirret nga banesa më shumë lagështi se sa në verë.

Në një familje me tre persona nëpërmjet çlirimit të avujve të personave (30 – 100 gr/orë për person) nga dushi, larja, therja e rrobave, gatimi, si dhe nga bimët, akuariumet dhe burime të tjera të lagështirës çlirohen çdo ditë afërsisht 6 deri 14


kg ujë. Për të nxjerrë jashtë nga mjediset e brendshme rreth 10 kg ujë duhet të lëvizen shumë metra kub ajër. Kjo do të thotë se sasia e ajrit të mjediseve të brendshëm duhet të ndërrohet mesatarisht 7 herë në ditë për të transportuar jashtë lagështirën e padëshiruar. Për krahasim: me dritare dhe dyer të mbyllura intensiteti i këmbimit të ajrit është afërsisht ndërmjet 0.2 dhe 2 ndërrime në orë (në varësi të tipit të dritares dhe situatës ndërtimore). Në drejtare të hapura krejtësisht intensiteti i këmbimit të ajrit rritet me 10 – 20 ndërrime në orë.

Sa më i keq të jetë termoizolimi i mureve të jashtëm ose sa më shumë gabime ndërtimore të jenë bërë në konstruksionin e ndërtesës (p.sh. në formën e urave termike) dhe sa më keq të ngrohen muret e jashtëme nëpërmjet qarkullimit të ajrit (p.sh. mbrapa dollapëve ose mbrapa veshjeve të mureve), aq më e ulët është temperaturat e sipërfaqes e këtyre mureve. Kështu rritet lagështia relative në sipërfaqet e brendshme të mureve, dhe si rrjedhim rritet rreziku i formimit të kondensatit të ujit.

Në mjediset e bodrumeve tek ndërtimet e vjetra temperatura e mureve anësore, shpesh herë edhe në verë, është e ulët. Por meqenëse lagështia absolute e ajrit të jashtëm në verë shpesh është e lartë ajrosja e shpeshtë me ajrin e jashtëm për ta tharë ajrin e brendshëm do të ishte e gabuar, sepse në mjedisin e brendshëm do të hyjë edhe më shumë lagështi dhe do të kondensohet në muret e ftohtë. Për këtë arsye ajrosja duhet të shtyhet në orën e para të mëngjesit.

Në bodrume, të cilat shërbejnë vetëm si depo dhe nuk janë të përshtatshme për qëndrim të gjatë të njerëzve, meret parasysh rënia dhe zhvillimi i mykut. Ndiheza do të që vetëm nëpërmjet një termoizolimi më të mirë, ngrohjes ose tharjes së ajrit të brendshëm.

Bodrume, në të cilat lindja dhe zhvillimi i mykut nuk pengohet, nuk duhet të kenë lidhje të drejtëpërdrejtë me pjesën tjetër të ndërtesës, si p.sh. nëpërmjet shkallëve, hapësirave vertikale ose hapjeve të pa hermetizuara në tavanin e bodrumit.



Në muret e jashtme nuk duhet të vendosen apo të varen, para së gjithash në muret e ftohta, mobilje, korniza ose perde të rënda. Si distancë orientuese vlen ajo prej afërsisht 10 cm.